



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 4, datë 25.02.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Shkurt, që zhvillohet tek salla e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:07

Data e mbajtjes së mbledhjes : 25.02.2022

Mbajtja e mbledhjes : salla e Qendrës Kulturore “ Aleksandër Moisiu”

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari z.Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi : Të nderuar Këshilltarë ! I nderuar Zëvendëskryetar !

Të nderuar pjesmarrës ! Të nderuara media!

E deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin shkurt të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë në detyrë. Gjithashtu do kemi dhe informim nga drejtues të administratës së bashkisë. I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga sekretaria e këshillit. E ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën.

Dorina Milja: Faleminderit Kryetar!

Fillojmë me prezencën. Jolanda Mustafaraj ... prezent..... etj Morena Boja.....prezent. Kryetar ke 31 këshilltarë në sallë. *(ndërkohë me vonesë ka hyrë dhe është ulur në sallë dhe Mahmut Mani)*, Mahmut Mani, 32 këshilltarë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqenëse kuorumi është i pranishëm po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN SHKURT 2022
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË OBJEKTEVE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 3 : 1. PALLATI ME 11 KATE, GODINA NR. 32, "USHINA", LAGJA 5, RRUGA "TEODOR RUPI", KODI GIS 22836, 2. PALLATI ME 11 KATE, GODINA NR. 8, LAGJA 5, RRUGA "STEFAN DHIMA", "NDREGJONI" SHPK, KODI GIS 23206
3. Informacion këshilltarëve	RAPORT MBI VEPRIMTARINË AUDITUESE TË DREJTORISË AUDITIMIT BRENDSHËM (01.01.2021-31.12.2021)

Ani Dyrmishi : Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket 3 pikave të rendit të ditës ?

Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1** të R.D, i kalojmë fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale nëpërmjet komunikimeve elektronike mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës, sipas propozimit të drejtorisë përkatëse të bashkisë dhe vendosi miratimin dhe kalimin për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka komente, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ?Nuk ka.

32 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **projektvendimit nr. 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar!

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 2 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar!

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Jani.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Përshëndetje Kryetar ! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin, propozon me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 2 kemi komente nga ana e këshilltarëve ?

Etleva Velçani : Kryetar nëse më lejon kisha 1 pyetje.

Ani Dyrmishi : Po.

Etleva Velçani : Nuk e di nëse këto projekte që vinë nga firma kontraktuese, sa , a ka ndonjë grup që i mbikqyr këto projekte që sillen nga firma kontraktuese? Pra nëse vet Instituti nuk merr përgjegjësinë, atëherë kush mban përgjegjësi për këto projekte? Nëse, në një rast konkret nuk është projekti ashtu siç rezulton në të vërtetë, në faktike, në terren ?

Ani Dyrmishi : Z. Kallmi.

Gentian Kallmi : Përshëndetje ! Faleminderit për pyetjen!

Studio projektuese është e kontraktuar nga Bashkia Durrës ka gjithë përgjegjësinë përkatëse në lëshimin e projektit dhe sipas hallkave ligjore kërkohet dhe oponenca teknike nga Instituti i Ndërtimit.

Etleva Velçani : Po, por oponenca teknike sillet në bazë të të dhënave që sjell firma projektuese dhe këtu flas për

Gentian Kallmi : Atëherë përgjegjësia është e firmës projektuese ka dhe një grup monitorimi të firmës projektuese nga Bashkia Durrës .

Etleva Velçani : Eh, këtë doja të dija nëse ka një grup. Kjo ishte pyetja.

Gentian Kallmi : Ka një grup monitorimi të projektit dhe zbatimit të projektit .

Etleva Velçani : Ok, faleminderit

Gentian Kallmi : Asgjë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Pyetje te tjera ose komente? Nuk ka, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës? Kundra ?.... Apstenim ?..... Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në pikën **3 të rendit të ditës** i japim fjalën Drejtoreshës së Njesisë së Auditimit të Brëndshëm në Bashkinë Durrës znj. Majlinda Palodhi.

Majlinda Palodhi : Përshëndetje të gjithëve !

Dëgjohet ? Mirë .

Në bazë të kërkesës Drejtorja e Auditit ka dorëzuar pranë jush “Raportin Vjetor të 2021 janar - 2021 dhjetor” dhe është paraqitur gjithë puna jonë vjetore mbi auditimin e njësive në varësi të Bashkisë Durrës. Nëse ka ndonjë pyetje rreth raportit të paraqitur?

Ani Dyrmishi : Pyetje besoj që nuk ka, por thjesht 2-3 fjalë sa për informim.

Majlinda Palodhi : Po. Drejtorja e Auditit të Brëndshëm punon në bazë të ligjit “Për Auditimin e Brëndshëm” dhe manuali. Njësia jonë përbëhet nga 2 specialist dhe 1 drejtues. Është njësi e vogël faktikisht dhe organizimi bëhet për auditimin vjetor të subjekteve të varësisë sesa bashkisë. Bashkisë mund t’i merret 2 deri 3 drejtori për auditim dhe pjesën tjetër e auditon KLSH. Nuk mund ta mbulojmë dot me numrin që ka Njësia e Auditimit të Brëndshëm.

Plani bëhet 1 vit përpara nga Drejtorja e Auditit, aprovohet nga Kryetari dhe pastaj gjithë vitin Njësia e Auditimit të Brëndshëm është e pavarur në auditimet që bën në njësitë e varësisë. I organizon, i auditon dhe të gjitha në fund fare ja paraqet Kryetarit. Kryetarja në varësi të problematikave të veta mund të na ndërpresë auditimin nëpër subjekte të ndryshme dhe të na drejtojë në një auditim tjetër që ajo e ka të domosdoshme për tu audituar në atë periudhë. Në këtë mënyrë funksionon Njësia e Auditimit të Brëndshëm.

Ani Dyrmishi : Ok faleminderit. Nëse ka ndonjë pyetje nga ana këshilltarëve?

Majlinda Palodhi : Faleminderit dhe juve.

Ani Dyrmishi : Po, z. Beqiraj.

Artion Beqiraj: Faleminderit .

Pyetja ka të bëjë në nivel krahasues me vitin e shkuar. Ka ndonjë gjetje më të veçantë, pra midis 2020 dhe 2021?

Majlinda Palodhi : Në përgjithësi trajtimi i subjekteve në varësi të bashkisë, “Ne” nuk jemi vetëm auditues për të kontrollu e për të gjet të metat, “Ne” njëkohësisht bëjmë punë përmirësuese gjithmonë kur shkojmë. Mendimi jonë është që është gjithmonë në përmirësim, jo....

Artion Beqiraj: Dhe pyetja për këtë ishte, pra për përmirësimin. Ok.

Majlinda Palodhi : Po, sigurisht , sigurisht se përmirësim ka, patjetër.

Artion Beqiraj: Faleminderit.

Majlinda Palodhi : Tashi ka problematika që s’janë hapur asnjëherë, u bë rindërtimi përshembull, që është një sektor i ri, që “Ne” auditojmë dhe nuk mund të themi se, në atë sektor, por për atje ku shkojmë gjithmonë, sigurisht ka përmirësim.

Ani Dyrmishi : Ok. Faleminderit .

Pyetje të tjera ?.....

Po, z. Karaj.

Agim Karaj : Faleminderit !

Për performacën gjatë kontrollit që keni ushtruar gjatë këtij viti, si duket bashkia jonë në performancë? Faleminderit .

Majlinda Palodhi : Po, unë më duket e bëra prezantimin që në fillim fare që “Neve” nuk auditojmë gjithë bashkinë, auditojmë vetëm disa drejtori se s’mundemi ta auditojmë.

Auditimin e performacës e ka bërë KLSH-ja për Bashkinë Durrës dhe “Neve” vet si staf nuk kemi kaluar në një auditim performance. Bëjmë auditim përputhshmërie, auditim të kombinuar, auditim financiar . Auditim performance për Bashkinë Durrës nuk kemi bërë asnjëherë. Ka bërë vetëm një herë KLSH. Ka bërë auditim performance Bashkia Durrës dhe auditim performance për rindërtimin. Dy auditime performance janë bërë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Znj. Boja .

Morena Boja : Përshëndetje !

Pyetja ime lidhet me afatet kohore. Ju thatë që ka dy mënyra të raporteve që ju prezantoni, janë raportet përmirësuese, në të cilat ju i leni kohë institucionit të përmirësojë raportin dhe raporte mbase, që nuk kanë mundësi përmirësimi, sepse ju i keni kapur në shkelje dhe më pas ju duhet t’i raportoni në institucionet përkatëse.

Pyetja ime është : A i monitoroni sërish ju këto raporte përmirësuese? Sa kohë i lini në dispozicion institucionit për përmirësim dhe nëse ju bëni një rikontroll pas periudhës kohore dhe e shikoni që nuk është përmirësuar çfarë ndodh në këto raste?

Majlinda Palodhi : Ne lejmë rekomandime në raporte. Brënda raporteve “Ne” lejmë rekomandime. Rekomandimet i kemi detyrim ligjor që t’i kontrollojmë çdo herë. Dhe ja, si tani në këtë moment në fillim të marsit “Ne” fillojmë një raport auditimi për mbarëvajtjen e gjithë rekomandimeve që kemi lënë “Neve” subjekteve në varësi të bashkisë. I kemi detyrim ligjor që pra t’i kontrollojmë rekomandimet e lëna nga neve në subjekt dhe e bëjmë.

Morena Boja : Flas për periudhën kohore, pra sa kohë i lini në dispozicion për përmirësim.

Majlinda Palodhi : Sipas problematikave. Siç është problemi ashtu...

Një rekomandim duhet të jetë i menjëhershëm, një rekomandim ...

Përshembull një rekomandim në një mbyllje bilanci ku pasqyrat nuk janë të rregullta, nuk paraqesin realitetin unë nuk mund t'ja kërkoj, një herë në vit se njëherë në vit bëhet bilanci nuk bëhet çdo muaj. Një problematikë tjetër që është në vazhdimësi e paraqesim, e kërkojmë menjëherë ose në vazhdimsi.

Morena Boja : Ok. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Pyetje të tjera ?

Atëherë s'ka . Meqë rendin e ditës mbaruam e ka kërkuar fjalën për diskutim znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit z.Kryetar!

Përshëndetje të gjithë pjesmarrësve në mbledhjen e sotme!

Ne si Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave ashtu sikurse të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak jemi njohur me “Raportin e përputhshmërisë së monitorimit të performancës në nivel bashkie për vitin 2020” publikuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Në këto kushte do t'i rekomandojmë administratës të Bashkisë Durrës të hartojë treguesit e performancës për çdo program buxhetor sipas kërkesave të udhëzimit të hartimit të projektbuxhetit afatmesëm të njëjësive të vetëqeversjes vendore. Padyshim që kjo do të përmirësonte buxhetin për të qënë më i qenësishëm dhe më i matshëm me indikatorët e performancës. Ju faleminderit .

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Znj. Velçani ka kërkuar fjalën.

Etleva Velçani : Faleminderit .

Të lutem Kryetar nëse më...., dua pak kohë që të bëj një përmbledhje të situatës në të cilën ndodhen banorët e pallatit nr.15, rruga “Abaz Çelkupa”. Situata është se duke qënë nga 1 vit, pothuajse 1 vit i plotë banorët shkojnë herë pas here pranë bashkisë për kërkesën për fatin e tyre se çfarë do të bëhet me këtë pallat, ndërkohë që nga bashkia i është thënë në mënyrë verbale që presim oponencën nga Instituti i Ndërtimit. Ndërkohë që banorët priten kaq kohë një përgjigje ju drejtuan vet personalisht me një kërkesë Institutit të Ndërtimit për t'i kërkuar se pse nuk po vjen kjo kërkesë, kjo përgjigje nga kërkesa që është bërë nga bashkia. Në të njëjtën kohë i kthen përgjigje nga Instituti i Ndërtimit tek i thotë që oponenca jonë ka dalë që me datë 11.03.2021. Ndërkohë që banorët nuk janë fare në dijeni të kësaj oponence dhe na rezulton që kjo oponencë ka një mbingarkesë të të dhënave që nuk janë faktike në terren. Pra, rezulton që këto matje, të cilat një firmë projektuese pretendon që i ka bërë në pallatin që bëhet fjalë nuk janë aspak të qarta, pasi vet banorët kanë qënë gjatë gjithë kohës në kontakt dhe asnjë, nuk ka ardh asnjë inxhinjer për të bërë matjet e themelit, gjëja që është më kryesore, i cili është nxjerr nga konstatimi i këtij projekti që është baza kryesore në të cilën ka shkuar dhe kosto 78 %, që do të thotë që është për demolim. Një gjë që banorët deri më sot nuk e dinë, sepse Instituti, priteshe që t'i vinte përgjigja nga Instituti. Dhe ndërkohë banorët kanë bërë një kërkesë pranë bashkisë për një rishikim të dytë, ngritjen e një komisioni për të rishikuar dhe njëherë dëmet e shkaktuara nga tërmeti i 26 Nëntorit. Dhe përgjigja,

kërkesa e parë është: A do të merret në konsiderat kjo kërkesë e bërë nga banorët e këtij pallati?
Dhe pyetja e dytë është : A jeni në dijeni ju për këtë oponentë të cilën mban datën 11.03.2021?

Gentian Kallmi : Po, faleminderit për pyetjen.

Atëherë duhet t'ju sqaroj që oponenti teknike e muajit mars 2021, sipas propozimit të projektuesit është kërkuar të demolohet dhe Instituti i Ndërtimit ka dhënë miratimin e demolimit. Banorët e këtij objekti kanë ardhur disa herë në zyrat e bashkisë kanë takuar në mënyrë verbale dhe Kryetaren e Bashkisë. Janë informuar mbi problematikat. Aktualisht që flasim bashkia është drejtuar duke vlerësuar situatën e social ekonomike mjedisore të vendodhjes së objektit, numrin e banorëve dhe ka kërkuar tek projektuesi një rishikim të projektit dhe në përgjigjen që do të vi nga projektuesi me propozimin e rishikuar do i ridrejtohem Institutit të Ndërtimit për oponentin teknike.

Etleva Velçani : Faleminderit .

Po me fal, doja dhe të sqaroja diçka që dëmtimet e këtij pallati kanë qënë DS3, dhe është bërë një aktekspertizë po nga Instituti i Ndërtimit vet, që ka sjellë një përgjigje ku thotë : "...që pallati nuk ka dëmtime në strukturë, por në muratur..", pra vetë inxhinjerët e ndërtimit e kanë bërë një aktekspertizë dhe nuk e nxorën me probleme këtë pallat. Si ka mundësi firma projektuese tashi nxjerr probleme të tjera që inxhinjerët e Institutit nuk e kanë parë një gjë të tillë? Mendoj t'i shikoj dhe firma projektuese. Pra, janë dy akt-ekspertiza të ndryshme nga njëra tjetra, kjo i shqetëson banorët se nuk është marrë mostra e themelit, ndërkohë që në oponentë thuhet : "... që themeli është 1 e 90". Ndërkohë a mendoni ju të paktën, nëse më ndihmon ndonjëri që është inxhinjer ndërtimi një pallat me themel 1e 90 me 13 kate, dhe thuhet që vertikalisiteti është ruajtur a do kishte qëndruar në këmbë ai pallat me një themel 1 e 90? Kjo është e pavërtetë. Një pallat, domethënë një oponentë e tillë nuk pranohet as nga ana teknike. Është e pallogjikshme.

Gentian Kallmi : Atëherë unë nuk jam inxhinjer. Nuk jam teknik...

Etleva Velçani : Prandaj thashë nëse është dikush për ndihmë .

Gentian Kallmi : Gjithsesi këtu kemi prezent dhe Drejtorin e Projekteve që mund t'ju përgjigjet. Po i kaloj fjalën, po i kaloj fjalën Nandit.

Etleva Velçani : Të më falni, po është një shqetësim shumë i madh. Domethënë nga oponenti që kam lexuar është për tu diskutuar.

Gentian Kallmi : Mundesh mikrofonin.

Adnand Toçila (*Drejtor i Projekteve dhe Infrastrukturës Publike*): Mirëdita !

Ne këtë problem e dimë dhe është problem i njohur . Domethënë kjo oponentë ka ardhur që në shtator në bashki dhe duke mos qënë dakort me këtë pjesë jemi drejtuar verbalisht disa herë dhe studios dhe Institutit të Ndërtimit. Vet Kryetarja ka marrë takim me drejtuesit e Institutit duke kërkuar jo vetëm për këtë objekt, por për disa objekte që ata janë të mendimit që duhet të demolohen, i ka kërkuar rishikimin e ekspertizës së thelluar. Tani dhe me kërkesën e fundit që jeni

drejtuar prap do t' i ridrejtohem qoftë studios, qoftë Institutit për të marrë parasysh kërkesat tuaja. Por duhet t' ju sqarojmë që pavarësisht objekteve me vendimet e fundit që kanë dalë me udhëzimet e fundit që kanë dalë nga Këshilli i Ministrave gjithë objektet, të cilat kanë patur dëme në strukturë duhet të rforcohen sipas Eurokod 8-tës. Prandaj dalin këto kosto mbi 70 % .

Etleva Velçani : Jam dakort me këtë pjesë, por ekspertiza thotë që nuk ka dëme në strukturë dhe ky është problem më i madh që banorët ngrejne .

Adnand Toçila : Tani unë gjë me vete nuk kam të lexoj, por do ta rishikojmë.

Etleva Velçani : Prandaj duhet një ekip i dytë që të bëj verifikim.

Adnand Toçila : Do ta rishikojmë. Kjo është me ngulm nga “Ne” nga të gjithë.

Etleva Velçani : Por, po të lutem kësaj radhe në mënyre zyrtare dhe jo verbale.

Ani Dyrmishi : Ok, faleminderit znj. Velçani. Faleminderit Nandi.

Etleva Velçani : Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët.

Atëherë nuk ka. Nëse Zëvendëskryetari ka diçka për të shtuar.

Gentian Kallmi : Faleminderit Kryetar. Unë ju falenderoj të gjithëve për pjesmarrjen.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë i ezauruam gjithë pikat, diskutimet e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ju faleminderit. Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretarja e Këshillit.

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 8(tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funksionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetari Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetari Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetare Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI